VENDIM
Nr. 47, datë 6.9.2017

PËR MIRATIMIN E DISA NDRYSHIMEVE NË RREGULLOREN "PËR LICENCIMIN DHE USHTRIMIN E VEPRIMTARISË NGA SUBJEKTET FINANCIARE JOBANKA"

Në bazë dhe për zbatim të nenit 1, pika 4, shkronja "b", dhe nenit 43, shkronja "c" të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, "Për Bankën e Shqipërisë", të ndryshuar; nenit 126 të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006, "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar; me propozimin e Departamentit të Mbikëqyrjes, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë

VENDOSI:

1. Në rregulloren "Për licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë nga subjektet financiare jobanka", miratuar me vendimin nr. 1, datë 17.1.2013, të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, të bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Në nenin 14, pika 1, bëhen këto ndryshime:

i) shfuqizohen shkronjat "c", "d", "e", "f", "k";

ii) pas shkronjës "k" shtohet shkronja "l" me përmbajtjen e mëposhtme:

"l) konstatohen shkelje ose problematika të veçanta, të parashikuara në nenin 35 të rregullores "Për administrimin e rrezikut në veprimtarinë e subjekteve financiare jobanka".

2. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes së Bankës së Shqipërisë për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

3. Ngarkohet Kabineti i Guvernatorit dhe Departamenti i Kërkimeve me publikimin e këtij vendimi, përkatësisht në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Gent Sejko